



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:160585

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589543

Ac.nr.1990/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca - Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësve E.M .dhe F.M. të dy nga fshati B., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson E.A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit H..M nga fshati B., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Q.R., avokat nga Lipjani, për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit H.M. nga fshati B., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve E.M.dhe F.M., të dy nga fshati B...dhe ka vërtetuar se paditësit e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë në ½ pjesë të paluajshmërisë në përbërje si vijon:

a) njësinë kadastrale nr. ..., me kulturë livadh i kl. IV, në vendin e quajtur “TRN ...”, në sipërfaqe prej 1336 m2, ZK B., me këtë matje dhe përkufizime gjeodezike në veri me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika 1 deri në pikën 2, në gjatësi prej 1.39 m, në vazhdim me njësinë kadastrale nr. ... nga pika 2 deri në pikën 3, në gjatësi prej 17.01 m, në lindje me njësinë kadastrale nr. .. nga pika 3 deri në pikën 6 në gjatësi prej 95.28m, në jug me njësinë kadastrale .., nga pika 6 deri në pikën

7 në gjatësi prej 10.11m, dhe në perëndim me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika 7 deri në pikën 1 në gjatësi prej 87.81m.

b) njësinë kadastrale nr. .. me kulturë livadh i kl. III, në vendin e quajtur "TRN" në sipërfaqe prej 6224 m<sup>2</sup>, ZK B..., me këto matje dhe përkufizime gjeodezike në veri me njësinë kadastrale nr. 661-0 nga pika 3 deri në pikën 9 në gjatësi prej 34.50 m, me njësinë kadastrale nr. ...-0, nga pika 9 deri në pikën 11, me gjatësi prej 29.45m, në lindje me njësinë kadastrale ..-1 nga pika 11 deri në pikën 13 në gjatësi prej 115.60 m, në jug me njësinë kadastrale ..-2 nga pika 13 deri në pikën 6 në gjatësi prej 66.60 m, dhe në perëndim me njësinë kadastrale nr. ..-0, nga pika 6 deri në pikën 3 në gjatësi prej 95.28 m dhe e ka obliguar të paditurin H.M. nga fshati B...që të duroj dhe lejoj paditësit që paluajshmërinë e përshtuar nën a) dhe b) ta regjistrojnë në regjistra të paluajshmërive në bashkëpronësi të tyre, në të kundërtën ky aktgjykim do të shërbej si dokument juridik për bartjen dhe regjistrimin e kësaj paluajshmërie në bashkëpronësi të paditësve dhe atë secilit nga ½ pjesë të paluajshmërisë. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka obliguar të paditurin që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditësve t'ua kompensoj shumën prej 1,967.60 Euro, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kësaj aktgjykimi, nën kërcimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesën ta aprovojë si të bazuar aktgjykimin i ankimuar të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo i njëjti të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*Ankesa e të paditurit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 12.05.2016 paditësit nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar kanë ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, për vërtetimin e të drejtës së bashkëpronësisë në ngastrën kadastrale nr. 00673-0 dhe 674-0, me kërkesë dhe arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se i ndjeri R.M. ka qenë gjyshi i paditësve, i cili i ka pasur tre djem dhe dy vajza dhe atë R.M.- babai i të paditurit H.M.; Q.M.- babai i paditësit E.M.dhe I.M.- babai i F.M., se në

vitin 1960 i ndjeri R.M.- babai i të paditurit është ndare nga bashkësia familjare me vëllezër dhe babën e tij dhe me këtë rast ka marrë vetëm truallin dhe një shtëpi të cilën bashkërisht e kanë ndërtuar të ndjerit vëllezërit me babin e tyre, se në vitet 1980-ta baballarët e paditësve, e kanë ndarë pasurinë e përbashkët të paluajtshme në mes veti, meqë rast prezent përveç vëllezërve-baballarëve të palëve ndërgjyqësore dhe i ndjeri gjyshi i palëve ndërgjyqësore R.M., kanë qenë edhe nipi i tyre J.P. nga fshati Mirash, si dhe të ndjerët V.R., A.M., Sh.M., se me marrëveshje gojore mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët të paluajtshme paluajshmëritë kontestuese u kanë takuar në pjesë të barabarta të ndjerit Q.M. -babai i paditësit E.M.dhe I.M. - babai i paditësit Fahredin, se që nga ajo kohë e deri sa kanë qenë në jetë baballarët e paditësve e pas tyre paditësit këto parcela i kanë shfrytëzuar pa asnjë shqetësim nga askush për deri sa të njëjtat janë shpronësuar dhe ka filluar ndërtimi i autostradës Prishtinë-H... Ka shtuar se këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve J.P. nga fshati M, I.B., S.M. dhe pjesërisht nga dëshmia e dëshmitarit M.Z. i cili deklaroj se këtë livadh e ka punuar Qazimi- baba i Enverit dhe Ismajli - babai i F për tërë kohën ndërsa asnjëherë nuk e ka parë duke punuar këtë tokë R- babain e të paditurit, nga deklaratave të paditësve E dhe F.M.të dhënë në cilësi të palëve, prova këto të cilave gjykata ua fali në tërësi besimin nga se ishin bindëse dhe e plotësonin njëra tjetrën, ndërsa ka arsyetuar se deklaratave të dëshmitarëve Z.Q. motër e nënës së të paditurit, H.R. , E B, N O - motrat e të paditurit, deklaratën e dhënë nga dëshmitari N.B.- burri i motrës së të paditurit si dhe pjesërisht deklaratën e M.Z.i-t fqinj i të paditurit nuk ua fali besimin dhe i vlerësoi si deklaratave subjektive.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë nxjerrjen e provave materiale përfshirë edhe ekspertizën e gjeodezisë nga ekspertja D.T.-G e cila ka bërë identifikimin dhe përkufizimin e ngastrave lëndore. Në fund ka shtuar se ka gjetur se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë në ½ e paluajtshmërive lëndore, mbi bazën e parashkrimit fitues ngase paraardhësve të paditësve me ndarjen e pasurisë së paluajtshme të përbashkët në vitet e 80-ta u ka takuar nga ½ e këtyre paluajtshmërive, që nga vitet 1980-ta kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paluajtshmërive kontestuese derisa kanë qenë gjallë e pas tyre paditësit i posedojnë dhe shfrytëzojnë në mënyrë të ligjshme dhe me mirëbesim më tepër se 20 vite dhe këtë paluajtshmeri e kanë shfrytëzuar pandërprerë, në mënyrë të qetë dhe të pa penguar nga askush, deri sot e kësaj dite, për çka edhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë si të bazuar.

Për bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata i është referuar dispozitës së nenit 20 par. 1 të Ligjit mbi Marrdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-ës, nr. 6) dhe dispozitës së nenit 28 par. 4 të po të njëjtit ligj.

Përkitazi me pretendimin e të paditurit se paluajtshmëria kontestuese është blerë nga babai i tij i ndjeri R në vitet 1963-1964, me të hollat që i ka marr në emër të dëmshtëpërblimit për lëndimin e këmbës në vendin e punës në firmën "K" në Maqedoni, por kjo paluajtshmeri është regjistruar në emër të gjyshit të tij të ndjerit R.M., për të shfrytëzuar shtesat feminare dhe se 1/3 e paluajtshmërive kontestuese me rastin e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore të gjyshit i ka takuar babait të tij të ndjerit R.M., pas vdekjes së të cilit për këtë pjesë të paluajtshmërisë është shpallur trashëgimtar, gjykata ka arsyetuar se këtyre deklaratimeve në mungesë të provave materiale nuk ua fali besimin, këtë për faktin se aktvendimet e trashëgimisë, sipas gjykatës kanë vetëm karakter

deklarativ, ndërsa nga dëshmitë e dëshmitarëve, u vërtetua në mënyrë të plotë dhe bindëse se paluajtshmëria kontestuese u ka takuar baballarëve të paditësve me ndarjen e pronës së përbashkët familjare, e të cilët sa kanë qenë në jetë e kanë pasur në posedim dhe shfrytëzim të pandërprerë, e pas tyre paditësit e kanë shfrytëzuar dhe poseduar pa ndërprerë dhe pa u shqetësuar nga askush me mbi 20 vite.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Pretendimi ankimor i palës ankuese se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së me arsyetimin se dispozitivi i është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e aktgjykimit është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë, pra duke vërtetuar drejtë aktin e posedimit dhe kohëzgjatjen e posedimit të paluajtshmërive lëndore. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Nuk janë pranuar pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit, të gjitha faktet thelbësore kontestuese i ka provuar me mjete të përshtatshme dhe të besueshme provuese dhe rrjedhimisht edhe i ka arsyetuar të njëjtat në raport me normën e zbatuar. Gjykata ka konstatuar se në vitin 1960 babai i të paditurit- tani i ndjeri R.M.- është ndarë nga bashkësia familjare me vëllezërit e tij – paraardhësit e këtu paditësve dhe babain e tij dhe me këtë rast është pajtuar që të marr vetëm truallin dhe një shtëpi të cilën bashkërisht e kanë ndërtuar të ndjerit vëllezërit me babain e tyre dhe se në vitet 1980-ta baballarët e paditësve, e kanë ndarë pasurinë e mbetur të përbashkët të paluajtshme në mes vete, përfshirë edhe këtu paluajtshmërinë lëndore dhe se që nga ajo kohë fillimisht paraardhësit e paditësve e pas vdekjes së tyre edhe paditësit e kanë punuar dhe shfrytëzuar në mënyrë të qetë dhe të papenguar nga askush. Gjykata e shkallës poashtu në procedurën e provave ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë të gjeodezisë e cila ka bërë identifikimin dhe përkufizimin e ngastrave lëndore, e cila ekspertizë është e plotë dhe e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit ngase në mënyrë të detajuar ka bërë përkufizimin sipërfaqes së ngastrave lëndore, andaj vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë dhe përfundimi i nxjerrë nga vlerësimi i tyre është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësve është i drejtë dhe i argumentuar. Me dispozitën e nenit 28 par. 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko civil respektivisht në kohën kur paraardhësit e paditësve kanë hyrë në posedim të ngastrave lëndore shprehimisht parashihet se: *“mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”*.

Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike kontestimore dhe drejtë ka vërtetuar faktin se paditësit përfshirë edhe parardhësit e tyre ngastrat lëndore i kanë pasur në posedim që nga viti 1980, pra për më tepër se 30 vjet dhe se nuk janë penguar ndonjëherë nga ndokush përfshirë të paditurin apo edhe parardhësinë e tij, në posedimin e këtyre paluajtshmërive, andaj gjykata me të drejtë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve në këtë procedurë, të cilin qëndrim e përkrah edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të palës së paditur, mirëpo i vlerësoi si të pabazuara për faktin se për këto pretendime janë paraqitur nga pala e paditur edhe në përgjigje në padi si dhe në seancat e mbajtura gjyqësore për të cilat gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye në aktgjykimin e ankimuar e me të cilat qëndrime dhe vlerësime të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë pajtohet në tërësi dhe janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I drejtë del të jetë vendimi mbi shpenzimet e procedurës i cili është në përputhje me dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së sipas së cilës dispozitë pala e cila humb procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1990/20, me datë 08.04.2024

Kryetarja e kolegjit,  
Halide Reka d.v.

Numri i lëndës: 2019:160585  
Datë: 18.04.2024  
Numri i dokumentit: 05589543